



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT  
ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE

Nr. 557 Regj

Lushnje, më 08.09.2021

VENDIM SHPALLJE

*(Lidhur me ekzekutimin e "Urdhërit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)*

Unë Endrin Kashari, me detyrë Kryetar i Zyrës së Përmbarimit Lushnje, pasi studiova aktet proceduriale të çështjes përmbarimore nr.557, datë 26.08.2021 bazuar në urdhërin e ekzekutimit nr. 247, datë 08.06.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje,

KONSTATOVA:

Se në datë 24.08.2021 është depozituar pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje së bashku me Urdhërin e Ekzekutimit nr. 247, datë 08.06.2021 për vendimin penal nr. 77, datë 09.04.2021 të Gjykatës së Shkallës së Shkallës së Parë Lushnje, me palë:

- Kreditor: Prokuroria Lushnje
- Debitor: Shpëtim Sulejman Sinani
- Objekti: Shpenzime proceduriale

Nga ana e Zyrës së Përmbarimit Lushnje ka filluar procedura në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr. Civile dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 " *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbimor Gjyqësor*", i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar. Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitori Shpëtim Sulejman Sinani nuk ka marr dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj, bazuar në nenet 133/a, 133/b, 144/a dhe nenit 517 të Kodit të Proçedurës Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin që ka ai ndaj palës kreditore Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit nr. 247, datë 08.06.2021 për vendimin penal nr. 77, datë 09.04.2021 të Gjykatës së Shkallës së Shkallës së Parë Lushnje.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 133/a, 133/b, 144/a dhe 517 të Kodit të Proçedurës Civile dhe ligjit nr. 8730, daë 18.01.2001 “ *Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmbimor Gjyqësor*”, i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marr parasysh edhe komunimin postar), nga data 09.09.2021 – 28.09.2021 të debitorit Shpëtim Sulejman Sinani;
2. Ky vendim përpilohet në pesë kopje, ku një kopje afishohet në vëndbanimin e fundit të palës debitore , një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës së Përmbarimit Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në këndin e publikimeve të Bashkisë Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Tiranë.
3. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Shpëtim Sulejman Sinani me banim në Koçaj, Nj. Ad. Fier Shegan, Bashkia Lushnje;
4. Pala debitore Shpëtim Sulejman Sinani me banim në Koçaj, Nj. Ad. Fier Shegan, Bashkia Lushnje të paraqitet pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje në lagjen “Çlirimi”, kati i parë, hyrja tek sekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe të marr kontakkte me përmbaruesin gjyqësor të çështjes përmbarimore për t’iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbarimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim e detyrueshëm sipas nenit 519 e ne vijim të Kodit të Proçedurës Civile.

*U shpall në Lushnje, sot më datë 08.09.2021*

KRYETARI I ZYRËS

Endrin Kashari

